Kronikë

Vrasja e 33-vjeçarit në Shkodër, shkak sherri për parkimin! 3 gëzhoja në vendin e ngjarjes, u qëllua me kallashnikov! Në kërkim autori dhe 4 të tjerë

Valter Fjerza mbeti i vrarë nga fqinji i tij në fshatin Hoti i Ri i Shkodrës, ndërsa policia bëri të ditur se vëllaiu nuk ishte pjesë e konfliktit për parkimin e makinës. Ai kishte shkuar pranë lokalit për të shuar sherrin mes të vëllait dhe 5 të rinjve nga fisi Mhilli kur u qëllua me automatik nga Klodian Mhilli. Autori dhe bashkëpunëtorët janë ende në arrati.

■ Vritet 33-vjeçari në Shkodër, i vëllai e gjen të ekzekutuar jashtë makinës

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

Gritburtu

Ergys Kavaja
22 Shtator, 08:35 | **Përditësimi: 22 Shtator, 11:42**

Share

SHKODËR- Valter Fjerza, 33-vjeç ***u vra*** mbrëmjen e së enjtes (21 shtator) në fshatin Hot i Ri të Shkodrës vetëm pak metra larg banesës së tij. I ri po shkonte me makinë në lokalin e fshatit pasi kishte mësuar se i vëllai, Kol Fjerza po konfliktohej me 5 djem të fsilt Mhilli. Sherri mes Kol Fierzës dhe autorit të dyshuar, Klodian Mhilli kishte lindur për një vend parkimi në mugicën e lagjes. 24-vjeçari Mhilli prentedonte se 35 vjecari Fjerza i kishte bllokuar rrugën për të hyrë në banesë.

Duket se ky ishte një konflikt i hershëm mes tyre, ç'ka percepitoi në një sherr me tone të larta në lokal. 24-vjeçari kishte martë me vete 4 familjarë për tu përballur me Kol Fierzën. Ndërsa viktima Valter Fjerza nuk ishte pjesë e konfliktit. Ai shkoi në ambientet e jashme të lokalit pasi mësoi se vëllai ndodhej vetëm përballë 5 djemve të moshës nga 20 deri në 38 vjec, të cilët ishin të armatosur. Sapo ka parë Valterin të zbriste nga furoristrada, 24-vjecari Klodian Mhilli ka qëlluar me automatik drejt tij duke e lënë të vdekur në vend. Trupi i pajetë i 33-vjecarit u gjet nga policia jashtë makinës, ndërsa autori dhe 4 të tjerët u arratisën.

[Sh].com

LEXO EDHE:
3 të rinjtë nga Shkodra shkëlqejnë në festivalin INTEL AI, krijojnë projektin me inteligjencën artificiale për lehtësimin e trafikut

Mëngjesin e kësaj të premteje policia e Shkodrës bëri të ditur se ka sekuestruar një armë pistoletë në vendngjarje, që dyshohet se e posedonte autori por që nuk shfetë përdorur në krim. Policia thotë se Fjerza u qëllua me automatik, i cili ende nuk është sekuestuar, ndërsa në vendngjarje u mbodhën 3 gëzhoja. Klodian Mhilli që dyshohet se kreu vrasjen, kushëriniptë e tij, Aleksandër, Paulo, Luçiano Mhilli si dhe Enton Dushaj janë janë shpallur në kërkim nga bluta e Shkodrës.

Rendit zhvillimet sipas orarit: Të Fundit

Ora 10:29

Vrasja e 33-vjeçarit në Shkodër, policia: Në kërkim autori dhe katër të tjerë! Gjenden 3 gëzhoja në vendin e ngjarjes

Policia e Shkodrës ka dhënë njoftim mbi vrasjen e ndodhur një natë më parë në Shkodër. Përveç autorit, policia ka shpallur në kërkim edhe katër të tjerë, që dyshohet se janë përfshirë në konfliktin që më pas agravoi deri në vrasjen e të riut Valter Fjerza.

Ai dyshohet se është qëlluar me kallashnikov, ndërsa në vendin e ngjarjes janë gjetur edhe 3 gëzhoja.

> *"Zbardhet dinamika e ngjarjes së ndodhur mbrëmjen e djeshme, në fshatin Hot i Ri, ku për shkak të një konflikti të çastit, jashtë një lokali, u vra me armë zjarri një 33-vjeçar. Policia identifikon dhe shpall në kërkim 24-vjeçarin që dyshohet se qëlloi me kallashnikov, në drejtim të automjetit me drejtues 33-vjecarin. Identifikohen dhe shpallen në kërkim 4 shtetas të tjerë, të dyshuar të përfshirë në konflikt.*
>
> *Gjenden dhe sekuestrohen një armë zjarri pistolete që dyshohet se e posedonte 24-vjeçari dhe 3 gëzhoja që u gjetën në vendngjarje. Si rezultat i punës intensive hetimore, të kryer nga shërbimet e Drejtorisë Vendore të Policisë Shkodër, menjëherë pas ngjarjes së ndodhur mbrëmë, rreth orës 21:48, në fshatin Hot i Ri, ku për shkak të një konflikti të çastit, u vra me armë zjarri kallashnikov, shtetasi V. F., është bërë e mundur zbardhja e dinamikës së ngjarjes dhe identifikimi i shtetasve të përfshirë në të.*
>
> *Në vijim të veprimeve procedurale, u identifikuan dhe u shpallën në kërkim shtetasit K. M., 24 vjeç, A. M., 23 vjeç, P. M., 22 vjeç dhe L. M., 20 vjeç, të gjithë banues në fshatin Hot i Ri, si dhe shtetasi E. B., 38 vjeç, banues në lagjen "Vojo Kushi". Nga hetimet e deritanishme dyshohet se këta 5 shtetas janë përfshirë në një konflikt të çastit, për motive të dobëta, jashtë një lokali në fshatin Hot i Ri, me vëllanë e 33-vjecarit, shtetasin K. F., 35 vjeç. Pas konflikstit, drejt vendit të ngjarjes është afruar me automjet, shtetasi V. F. Sapo ka paré automjetin, shtetasi K. M. dyshohet se ka qëlluar disa herë, me armë zjarri kallashnikov, në drejtim të 33-vjecarit, i cili për pasojë, mbeti i vrarë.*
>
> *Policia gjeti dhe sekuestroi me cilësinë e provës materiale, një armë zjarri pistolete (dyshohet në posedim të shtetasit K. M.) dhe 3 gëzhoja që u gjetën në vendngjarje. Vijojnë kërkimet intensive për kapjen e 5 shtetasve të shpallur në kërkim dhe për gjetjen e armës me të cilën është kryer vrasja, si dhe vijojnë hetimet e thelluara për të individualizuar përgjegjësinë penale për këtë rast. Materialet procedurale i kalojan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, për veprime të mëtejshme", njofton policia.*

Sl.E./Shqiptarja.com

Share

Sl.E./KT/Shqiptarja.com

TAG: Shkodër | valter fjerza | kole fjerza | Enton Dushaj | Luçiano mhilli | Paulo mhilli | aleksander mhilli | vrasje

Komente

Policia: 22/09/2023 08:59

Vertet besoni ato qe shkruani aman... nuk ekzekutohet njeri per parkim.. apo harroni sa CANABIS u mboll andej perpjet... per ate pune qe ka 30 vjet qe ndodh ... prandaj vriten ne ate zone.. e jo per parkime

Prikurori: 22/09/2023 09:39

Po nuk besove parkimin e gabuar, atëherë e kanë vra se i ka shkue shtrembët.

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

[Sh].com

Sondazhi i ditës:
Ndryshe nga biznesi i vogël profesionet e lira do të tatohen, si ju duket?

E drejtë | E gabuar | Nuk e di

Lajme të tjera

Vritet 33-vjeçari në Shkodër, i vëllai e gjen të ekzekutuar jashtë makinës! Shkak dyshohet një konflikt në lokal (EMRI+VIDEO)
21 Shtator, 22:18

Plagosi me thikë të riun pas një konflikti të çastit, vihet në pranga 3 ditë pas ngjarjes 17-vjeçari në Shkodër
21 Shtator, 11:51

Kanabis, dhunë dhe kundërshtim të policisë, vihen në pranga 2 persona në Shkodër! 3 nën hetim 1 në kërkim
20 Shtator, 11:35

Vrau 39-vjeçarin shqiptar, greku shfaqet i penduar për krimin: Ishte gabimi më i madh i jetës sime
19 Shtator, 17:22

VIDEO/ Shkodër, digjet banesa në lagjen Dudas
19 Shtator, 14:36

Vidhnin energji elektrike nëpërmjet një linje të dytë, OSHEE padit 5 bujtina në Theth dhe një pulari në Shkodër
19 Shtator, 08:39

'Censi 2023', procesi nuk nis në Kukës, shkak zgjedhjet! Report Tv ndjek në terren anketuesit e INSTAT në disa qarqe! Regjistrimi elektronik me tabletë dhe hartë digjitale
18 Shtator, 17:26

Ndërprerje të energjisë për disa orë në Shkodër, OSHEE: Po kryhen punime në rrjet! Ja zonat që do të mbesin pa drita nga nesër
18 Shtator, 16:11

Vranë shqiptarin brenda shtëpisë së bartë në Angli, jepet vendimi për 13 anglezët, disa dënohen me burgim të përjetshëm
18 Shtator, 16:11

EMRAT/ Plagosje me armë zjarri në Malësi të Madhe, arrestohet autori! Qëlloi me pistoletë 30-vjeçarin
18 Shtator, 16:05

Shkodër, sherr me thika mes dy adoleshentëve, njëri përfundon në spital
18 Shtator, 15:51

Turqi/ E goditi me thikë ne zemër, 17-vjeçari vret shokun e ngushtë për një postim në rrjetet sociale
18 Shtator, 15:49

© 2011 - 2023 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje